



REPUBLIKA E KOSOVËS -- KOSOVA CUMHURIYETI  
REPUBLIKA KOSOVA -- REPUBLIC OF KOSOVO



MAMUŞA BELEDIYESI -- KOMUNA E MAMUSHËS  
OPŞTINA MAMUŞA -- MUNICIPALITY OF MAMUSA

**KUOTIMI I ÇMIMEVE  
PROKURIMI ME VLERË MINIMALE**

*Sipas Nenit 37 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Data e Ftesës: 24.09.2019

Numri i Prokurimit	626	19	036	147
--------------------	-----	----	-----	-----

**NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtar: <b>Komuna Mamushës</b>	
Adresa e AK: <b>Rruga "Sahat Kulesi" Ndërtesa e Komunës Mamushës</b>	
Qyteti: <b>MAMUSHË</b>	Kodi Postar: <b>20540-Mamushë</b>
Personi kontaktues: <b>GAZMEND GASHI</b>	e-mail: <b>mamushaprokurimi@gmail.com;</b>
Telefoni: <b>038 200 45 211</b>	Faksi: <b>029 273 048</b>

**NENI II: IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

Emri i OE: <b>NAT YAPRAK</b>	Personi kontaktues: <b>MUHAMET BAYRAKOR</b>
Adresa: <b>MAMUSHË CUMHURIYETI</b>	Telefoni: <b>044 415 864</b>
Qyteti: <b>KOSOVA-MAMUSHË</b>	Faksi: <b>029 273 072</b>
Kodi Postar: <b>20540</b>	E-mail: <b>YAPRAK-mamusa@h.com</b>

**NENI III: TË DHËNAT NË LISTEN E CMIMEVE**

**III.1) TITULLI I PROKURIMIT**

**"FURNIZIMI ME MATËRIAL PËR PASTRIMIN E RRUGËVE LOKALE DHE MIRËMBAJTJEN E HAPSIRAVE PUBLIKE NË MAMUSHË"**

III.1.1) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): **28000000-2**

III.2) Në mënyrë që të dëshmohet se Operatori Ekonomik (OE) është i përshtatshëm që të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, OE duhet të nënshkruaj dhe të paraqes **1.Certifikatën e regjistrimit të biznesit, 2.Certifikatën e Regjistrimit të Numrit Fiskal nëse nuk është e parafshirë në certifikatën e biznesit, certifikatën e tvsh-s (nëse O.E është deklarues i TVSH-S) dhe ta nënshkruaj, vulosë dhe te paraqes me kuotimin e tij Deklaratën nën Betim të bashkangjitur në faqen 5.**

III.3) **OFERTA JUAJ DUHET TE DERZOHET TEK AUTORITETI KONTRAKTUES ME SE LARGU DERI 30.09.2019 ORA 13:30**

III.4) **VLERA E PARASHIKUAR E KONTRATES PER KETE KUOTIM ME VLERE MINIMALE ESHTË: 920.00 €.**

### III.5) PËRSHKRIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS:

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)	Çmimi Total - €
1	Furnizimi me thas per mbeturinatëzeza , paketimi 1/10 copa, me 150 l vëllimindhe me trashësi 0.20 mm	copë	95	2,70	256,50
2	Furnizimi me dorezapune per punetoret	copë	50	0,35	17,50
3	Furnizimi me plehraartificiale per plehrimin e vendevegjelbertaneparqedhedfidanevedrun ore, loji NPK 15:15:15, 1/25kg.	kg	250	1,15	287,50
4	Furnizimi me gypplastikës PPE , ne trashesi 3/4 per ujitjen e drunajave,barojevesidhelulevenëpërvendegjel berta	m1	200	0,60	120
5	Furnizimi me herbicid total per mbrojtjen e oborreve me kubzangabarrojetëkëqija, sasiaprej 1 litrash	lit	15	4	60
6	Furnizimi me dhe organik - humus per plehrimin e lulevedhedrunajavedekorative 70 LITRASH	thas	20	7	140
7	Furnizimi me brushadhe bishtepërfshirjen e rrugevedhetotoareve	copë	5	2,20	11
8	Furnizimi me brushadhe bishtepërfshirjen e rrugevedhetotoareve	copë	5	4,80	24
Verejtje:Artikujt duhet të përputhen me specifikimet teknike si në këtë listë të çmimeve.Në rast të ndonjë defekti të mallit O.E obligohet që ta zavendësoj atë me mall tjetër pa defekt.					
Totali i përgjithshëm duke i përfshirë të gjitha taksat dhe tatimet e aplikueshme në Kosovë					916,50

Nënshkrimi i zyrtarit te prokurimit të AK-së	Nënshkrimi i përfaqësuesit të OE-së
Emri dhe Mbiemri: <b>GAZMEND GASHI</b>	Emri dhe Mbiemri: <b>MUHARREM DAVRACI</b>
Pozita: <b>Udhëheqës i sektorit të Prokurimit</b>	Pozita: <b>MANAGER</b>
Nënshkrimi: <i>Gashi</i>	Nënshkrimi: <i>DAVRACI</i>
Data: <b>05.10.2019</b>	Data: <b>25.09.2019</b>
Vula: 	Vula: 

## DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: \_\_\_\_\_ deklaroj nën betim se unë jam i përshtatshëm sipas nenin 65, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	NPT YAPRAK
Adresa e plotë:	MAMUSHE
Përfaqësuar nga:	CEVOST BAYRAKTAR
Emri	MUHAMET BAYRAKTAR
Pozita	MANAGJER
Nënshkrimi	
Data	09.09.2019
Vula	

### Kërkesat e Përshtatshmërisë

(Sipas nenit 65 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092)

1. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij:**
  - a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;
  - b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit; ose
  - c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75.
  
2. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara:**
  - a. është dënua nga një gjykatë kompetente për vepër penale duke përfshirë praktikumin e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se nën ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
  - b. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rënde profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;
  - c. është dënua nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme;
  - d. është dënua nga një gjykatë kompetente për vepër penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
  - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
  - f. është konstatuar nga ndonjë gjykatë kompetente se ka bërë keqëprezantim te ndonjë autoritet publik në Kosovë apo gjetiu.
  
3. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik:**
  - a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent; apo aktualisht është objekt procedure (i) për deklarim të falimentimit, (ii) për një urdhër të mbylljes së dhunshme ose administrimi nga një gjykatë, apo (iii) për ndonjë procedurë të ngjashme sipas Ligjit të Kosovës apo ndonjë juridiksioni tjetër;
  - b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
  - c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafët që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
  - d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
  - e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga operatori ose për atë operatori ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
  - f. aktualisht është objekt i një vendimi gjyqësor ose procedure administrative që suspendon ose redukton pagesat nga operatori ekonomik ose për operatorin ekonomik; nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
  - g. gjatë (3) tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë entitet publik, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë apo diku tjetër;
  - h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm në Kosovë;
  - i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
  - j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;
  
  - k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes; ose
  - l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.